

-58-

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 10 Date 26.07.2011

“PER
MIRATIMIN E LEJES
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, neni 18 germa dh, dhe te vendimit nr. 87 dt. 16.01.2008 te K.M., “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, ne Kreun XI, piken 9, “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”, si dhe te V.K.M. nr. 708 dt. 21.05.2008, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

- 1- MIRATIMIN e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore, lumi Shales , Komuna Shale, Rrethi Shkoder, per hidrocentralin ” NDERLYSE ”, Shoqerise “SHALA ENERGY” sh.p.k. per prodhim hidroenergjie, nga kuota e vepres te marrjes, + 595 m ne lumin e Thethit dhe + 600 ne perroin e Zi, deri ne kuoten + 484 m. ne lumin e Shales ku do ndertohet godina centralit. Prurja mesatare eshte $Q= 13.71 \text{ m}^3/\text{sek}$. Sasia e ujit qe do perdore eshte $Q= 21 \text{ m}^3/\text{sek}$. Shoqeria ka Kontrate Koncesionare me M.E.T.E. me nr. 3722 rep. Nr. 488 kol.
- 2- Leja e perdorimit te rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA



Kryetari

Sekretari Pergjithshem i Prefektures

Fatbardh SHEQI